A.K.P.A.
Nr 2891 Prot.
Datë,më 02.11.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QËNDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK FIER

Nr . 661/1 **Prot** **Fier , më** 30.10 .2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë .

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr. 759 datë.30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional", i ndryshuar

Qëndra e Formimit Profesional Publik Fier , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin me kohë të pjesshme :

- _Instruktor i praktikës profesionale në kursin " Aftësi për punësim " , në Berat 1 (një) person.

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- Të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose - parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- Të ketë të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2.Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin:
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën/deftesë e shkollës së mesme;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore:
- vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm;
- të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit publik të AFP-së, brenda datës ...09.11.....2026.

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 27.5.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

DREJTOR

Klotilda NAÇO

L:"16 Prilli" ,Rr:"Llukan Toska" Fier ,Albania drfppfier@akpa.gov.al